

RTSH
TIRANË



RADIO
TELEVIZIONI
SHQIPTAR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME

TIRANË MË, 01/102/2019

NR. PROT, 3/12

Lënda: Kërkesë për shtesë të fondeve për Shpenzime Kapitale

Drejtuar: Znj. Anila DENAJ
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Per dijeni: Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik
Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike
Degës së Thesarit Tiranë

Gjatë muajit Dhjetor 2018 dhe Janar 2019, RTSH ka përcjellë shkresa në Ministrinë e Financave në lidhje me ecurinë e investimeve në teknologji, në zbatim të Aktit Normativ nr.1, datë 26.07.2018, "Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 "Për Buxhetin e Vitit 2018", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit",

RTSH ka zbatuar të gjitha procedurat për realizimin e Investimeve në Teknologji në RTSH AGRO në vlerën 100 milion ALL (një qind milion lekë).

RTSH më datë 9 Nëntor 2018 realizoi procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me objekt "Blerje pajisje për kanalin RTSH Agro".

Kjo procedurë prokurimi pati ankesa dhe nga ana jonë u mbyllën veprimet në sistem elektronik me dt. 21.12.2018, pasi erdhi vendimi me Nr. 865/2018 dt. 20.12.2018 nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe për rrjedhojë kontrata nr.87/13 u nënshkrua më datë 24 Dhjetor 2018.

Gjate kësaj periudhe janë depozituar në RTSH tre fatura, më datë 26.12.2018 në vlerën 12,856,800 lekë, më datë 28 dhjetor në vlerën 8,550,000 lekë dhe në datë 28 Dhjetor fatura në vlerën 80,548,800 lekë, për të cilat po levrohen edhe pajisjet e tenderit në zbatim të kontratës..

RTSH e ka të pamundur përballimin e këtij investimi nga fondet e veta në vitin 2019.

Gjatë vitit 2019 buxheti i RTSH paraqitet me ulje në vlerën 150 milion lekë në zërin Investime nga fondet buxhetore në zërin Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja (në krahasim me parashikimin 2017,2018).

Ndodhur edhe përballë kostove shumë të larta të digjitalizimit dhe kësteve të kredisë është krenjtësisht i pamundur kryerja e këtij investimi nga RTSH, si edhe penalitetet që shkaktohen nga mosrespektimi i detyrimit kontraktor.

Lutemi të shihet mundësia për shtesën e vlerës 100 milion lekë për shpenzime kapitale për RTSH-në në këtë situatë të vështirë ekonomiko-financiare, relatuar gjatë gjithë vitit 2018 në Këshillin e Ministrave dhe në Ministrinë e Financave.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORI I PËRGJITHSHMË RTSH

Thoma GELI

Thoma GELI

